



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 698/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.11.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me nr. REF-32155-07-31-2019 me objekt: “Mirmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”, me fond limit 2.708.886 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).”

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sha., në procedurën e mwsipërme të prokurimit

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kadiu” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

“Power Industries” sh.p.k.
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Qendra Alpas, Hyrja 1, Kati 5, Ap. 14, Tiranë

“Alstezo” sh.a.

Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rruga “Butrinti”, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).
Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 8 Tiranë

Subjekt i Interesuar: “Kadiu” sh.p.k.
Kashar Tiranë Kashar, KASHAR, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5,
Mëzez, Ndërtese Private, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.Pasurie 19/25

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimes kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.08.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me nr. REF-32155-07-31-2019 me objekt: “Mirmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”, me fond limit 2.708.886 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).”

II.2. Në datën 04.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitimin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 09.09.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Power Industries” sh.p.k.	2.268.000 lekë, skualifikuar
2. “Servis Auto 2000” sh.p.k.	2.486.990 lekë, skualifikuar
3. “Alstezo” sh.a.	2.691.000 lekë, skualifikuar
4. “Kadiu” sh.p.k.	2.706.800 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 09.09.2019 operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyt si më poshtë vijon:

Nuk është cilësuar numri i urave ngritëse , sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik, pika 4 gërma C.

Nuk është cilësuar paraqitja e nje aparati saldimi , sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik, pika 4 gërma E.

II.4.1. Në datën 13.09.2019 operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...] Parashtrime:

Me date 04.09.2019 kemi mane pjese ne proceduren e zhvilluar nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane me objekt "Mirmbajtje, riparim dhe vendosje e pjeseve te kembimit per automjetet e Fondit".

Me date 09.09.2019 nepermjet APP jemi njohur me vleresimin e ofertave ekonomike si me poshte:

1. “Poëer Industries” sh.p.k.	2.268.000 lekë, skualifikuar
2. “Servis Auto 2000” sh.p.k.	2.486.990 lekë, skualifikuar
3. “Alstezo” sh.p.k.	2.691.000 lekë, skualifikuar
4. “Kadiu” sh.p.k.	2.706.800 lekë, kualifikuar

ku shoqeria jone e renditur e para me oferten mete ulet rezulton e skualifikuar me pretendimin se: Nuk eshte cilesuar numri i urave ngritese .sipas pikes 2.3,kapaciteti teknik,pika4 germa C nuk eshte cilesuar paraqitja e nje aparati saldimi.sipas pikes 2.3,kapaciteti teknik,pika 4 germa E. Ne si pale e prekur/demtuar nga vendimi i marre nga KVO ne baze te nenit 63 Pika2 te LPP , "Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet.se pari.me shkrim, autoritetit kontraktor nejjale brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes kur ankimes i eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni pershkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji" po ju drejtohem me ane te kesaj ankese duke kundërshtuar pretendimet e ngritura nga autoriteti juaj per skualifikimin e shoqerise sone pasi jane te pa mbeshtetura ne ligj dhe fakte si dhe ne kundërshtim te plote me zhvillimin e nje procedure te hapur dhe te barabarte prokurimi.

Deklarate e Hollesishme e Argumenteve :

Nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. Me marrjen pjese ne proceduren e prokurimit, operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave te tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk eshte percaktuar apo vendosur ndonje kerkesa specifike ne lidhje me piken 4 te kriterëve te vecanta per kualifikim se me cfare duhet te vertetojne OE disponimin e paisjeve te kerkuara ,konkretisht kerkesa e vendosur nga ak ne DST ka qene:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne perberie te servisit repartet si vijon:

a) Reparti elektroauto, i pajisur minimalisht me:

- pajisje per diagnostikimin e automjeteve;
- banke-prove per dinamo, motorino.
- aparat per rregjistrim feneresh.
- aparat per kontroll rrjedhjesh dhe mbushje me gaz i sistemit te kondicionimit.
- te gjitha pajisjet e tjera te nevojshme per repartin e mesiperme.

b) Reparti motorist, i pajisur minimalisht me:

- pajisje per matjen e komprimimit te motoreve diesel
- pajisje per matjen e komprimimit te motoreve me benzin
- aparat per kontroll presionit ne sistemin e ftohjes te motorrit.
- te gjitha pajisjet e tjera te nevojshme per repartin e mesiperme.

c) Reparti Xhenerik, i pajisur minimalisht me:

- ura ngritese per automjete, cope 4 (kater);
- aparat per furnizimin me alkol dhe nxerjen e ajrit te sistemit te frenimit;
- linje testimi elektronike per sistemin e frenimit te mjeteve.
- te gjitha pajisjet e tjera te nevojshme per repartin e mesiperme.

d) Reparti Gomisteri, i pajisur minimalisht me:

- aparat konvergjence per automjete, cope I (nje);
- pajisje montim-zmontim gomash, cope I (nje);
- pajisje balancim gomash, cope I (nje);

-te gjitha pajisjet e tjera te nevojshme per repartin e mesiperm.

e) Reparti llamarinist-bojaxhi, i cili duhet te jete minimalisht i pajisur me:

-aparate saldimi

-furre per pjekje boje dhe te gjitha pajisjet e tjera ndihmese.

-te gjitha pajisjet e tjera te nevojshme per repartin e mesiperm.

j) Kompjuter per diagnostikimin e automjeteve, i pajisur me programe per te gjitha llojet e automjeteve deri ne fund te vitit 2018.

Pra AK ka kerkuar Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne perberie te servisit repartet si vijon por ne asnje moment nuk ka percaktuar dokumentin konkret se me cfare duhet te vertetohet qe keto paisje jane ne perberje te servisit. Shoqeria jone per te lehtesuar punen e AK ka paraqitur nje deklarate (bashkangjitur) ku deklaroi sipas kerkeses se AK qe disponon te gjitha paisjet e nevojshme te kerkuara nga ana juaj per kete procedure, gjithashtu ka paraqitur edhe Bilancin e vitit 2018 ku ne perberje te te cilit eshte inventari i pasijeve qe shoqeria disponon (bashkengjitur). Pra jo njeher ,por dy here ne kemi paraqitur dokumenta qe konfirmojme disponimin e paisjeve te kerkuara nga ana juaj.

Nderkohe qe AK per shkaqe te pakuptueshme dhe te pabazuara skualifikon shoqerine tone me pretendimin se ne nuk kemi deklaruar numrin e urave qe diponojme, te nderuar lista e inventarit te shoqerise eshte mese e qarte, e lexueshme dhe e kuptueshme nga specialistet tuaj, nese do te deshironin te vleresonin drejte kete procedure, ku jane me shume se 4 ura te kerkuara nga ana juaj.

Ne kemi deklaruar qe i disponojme dhe i plotesojme kerkesat tuaja per ura dhe kemi jo 4 por 7 te tilla ... kjo mund te verifikohet lehtesisht nga ana juaj me ate dokumentave te paraqitura nga ana jone . Nuk mundet qe AK per shkak se ashtu deshiron pavaresisht se nuk gjen mbeshtetje as ne ligj dhe as ne fakte, te skualifikoje shoqerine tone dhe akoma me keq per nje dokument apo kerkes te cilen nuk e ka kerkuar fare ne DST ... Autoriteti juaj ka skualifikuar shoqerine tone mbi bazen e nje kriteri te pakerkuar duke shkelur nenin 55 "Kriteret e Percaktimit te Ofertes Fituese" pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor ne vleresimin e ofertave nuk mund te perdore asnje kriter tjeter i cili nuk eshte i perfshire ne kriteret e kualifikimit te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne kete kuptim nese autoriteti nuk ka kerkuar shprehimisht dokumentacion konkret sikunder eshte deklarata apo "cilesimi me ane te cdo lloj dokumenti tjeter " nuk mund te perdore si argument skualifikues mungesen e dokumentit i cili verteton/cileson numrin e urave pasi ne keto kushte autoriteti kontraktor ka vleresuar ofertat ne kapercim te kriterëve te vendosura nga vete ai ne kete procedure prokurimi.

Per reference vendimi nr. 414/2019 i KPP.

Te gjitha kerkesat e percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike jane permbushur nga shoqeria ndaj "arsyeja" e skualifikimit te dhene nga ana AK, KVO nuk qendron, dhe nje kriter i pakerkuar ne dokumentat e tenderit nuk duhet te perbeje shkak per skualifikimin e nje operatori ekonomik.

Sa me siper, autoriteti kontraktor, duhet te udhëhiqet nga parimi i mireperdorimit te fondeve publike dhe perfitimi i nje sherbimi me cilesi te mire dhe me cmim me te ulet, si edhe nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale. I njejti arsyetim vlen edhe per pretendimine dyte te ngritura nga ana juaj ,ku thuhet se nuk eshte cilesuar paraqitja e nje aparate saldimi, sipas pikes 2.3, kapaciteti teknik, pika 4 germa E ,kur kjo eshte e dukshme dhe e cilesuar si ne deklarate ashtu e edhe ne inventarin e shoqerise

. Sygjerohet AK që të vlerësojë me kujdes dokumentat e paraqitura nga ana e jone dhe të mos dale në përfundime të nxituara dhe gabuara, duke vonuar relativizimin e procedurës. Për këtë arsye kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sone, pasi me dokumentacionin e paraqitur shoqëria jone ka plotësuar kriteret për kualifikim konform kërkesave të autoritetit DST dhe se skualifikimi i ofertës sone është here në mënyrë arbitrare dhe jo të bazuar. Nëse OE të bindur për ligjëshmërinë e kërkesave tona do të ndjekim të gjitha rruget dhe instancat ankimit[...].

II.4.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimit, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit rezultoi se nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimit brenda afatave ligjore të parashikuara në ligj.

II.4.3. Në datën 27.09.2019 operatori ekonomik "Power Industries" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e bërë pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 09.09.2019 operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me pretendimin si më poshtë:

Mungon leja mjedisore e tipit C, kodi III.1A, në kundërshtim me piken 2.3, për kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues të jete i pajisur me leje mjedisore të tipit C, Kodi III.1.A.

II.5.1. Në datën 21.11.2014 operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë, në mënyrë të përmblodhur pretendohet si më poshtë:

[...]Kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar më dt.04.09.2019, nga AK - FSDKSH me objekt "mirembajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e fondit", me fondin limit: 2.708.886 (dy milion e shtatëqind e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Leke pa TVSH. Jemi njohur me klasifikimin e ofertave më dt.09.09.2019, si më poshtë vijon:

- | | | |
|----|----------------------------|------------------------------|
| 1. | "Poëer Industries" sh.p.k. | 2.268.000 lekë, skualifikuar |
| 2. | "Sërvis Auto 2000" sh.p.k. | 2.486.990 lekë, skualifikuar |
| 3. | "Alstezo" sh.p.k. | 2.691.000 lekë, skualifikuar |
| 4. | "Kadiu" sh.p.k. | 2.706.800 lekë, kualifikuar |

Jemi informuar se oferta jone është refuzuar dhe skualifikuar nga ana e KVO-se së këtij AK, me arsyetimin, si vijon: Mungon leja mjedisore e tipit C, kodi III.1A, në kundërshtim me piken 2.3, për kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues të jete i pajisur me leje mjedisore të tipit C, Kodi III.1.A. E kundërshtojmë këtë vendim të KVO-së për skualifikimin e ofertës tonë me argumentimin konkretisht si më poshtë: Lidhur me piken e pare të pretenduar nga AK, sqarohet: Autoriteti Kontraktor pretendon, si më poshtë: Mungon Leja mjedisore e tipit C, kodi III.1.A, në kundërshtim me piken 2.3 për kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues të jete i pajisur me leje mjedisore të tipit C, Kodi III.1.A. Në Shtojcën e DST, shtojca 7, pika 2.3. pika 6, nga ana e AK-se është kërkuar:

Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C, Kodi III. IA, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III. LB, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB).

Sqarojme se ne plotesim te ketij kriteri, lidhur me kryerjen e sherbimit dhe te riparimeve, ne si Operator kemi paraqitur dokumentat ne emer te Shoqerise ALSTEZO sha, sikurse jane:

Lejen e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, ku eshte percaktuar kodi 111.1.B per ndikimin ne mjedis, nenkategoria Leje e Mjedisit e tipit B, me emertim pershkrues te veprimtarise " Leje Mjedisit e tipit B per : Ringjyrosje ose sprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe motocikletave; Larje dhe pastrim mjetesh motorike"

Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar leje mjedisore e tipit C kodi III. LA per veprimtarine objekt prokurimi, dhe leje mjedisore e tipit B kodi III.Lb per repartin e bojatisjes se mjeteve. Autoriteti kontraktor nuk e ka lexuar me vemendje dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria jone, ne te kundert do te shihet se ky dokumentacion eshte ne perputhje me kriterin e kerkuar si dhe me legjislacionin ne fuqi.

Sa me siper, sqarojme KVO se legjislacioni ne fushen e mjedisit i ka te percaktuar shume qarte kategorite dhe tipet e lejeve qe leshohen ne fusha te caktuara.

Konkretisht, ne ligjin 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, ne Nenin 3, pika 13 eshte cituar :

13. "Leje mjedisit e tipit B" eshte leja e perqatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila leshohet nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, t'eresisht ose pjeserisht, instalimit te tipit B, siaps percaktimit te ketij ligji dhe qe permban te shkuara kushtet e nevojshme per te garantuar se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime ose pjese te instalimeve ne te njejten vendndodhje dhe ge operohen nga nie i nieiti operator.

Ndersa ne nenin 20 po te ligjit 10448 date 14.07.2011 eshte percaktuar se: "E njejta leje mjedisit e tipit B mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtit operator, ne te njejten vendndodhje. Instalimet e operateve te ndryshem, qe ndodhen ne te njejten vendndodhje dhe instalimet e te njejtit operator, qe ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kerkojne leje te vecanta te tipave A, B apo C, sipas rastit".

Sa me siper ne nje vendndodhje mund te besh nje leje B qe ti perfshije te gjitha - pra dhe lyerjen dhe servisin per riparim te mjeteve motrrike vetem nje leje mjedisit. Kategoria zgjidhet ajo me e madhja, pra kategoria B, si kategori me e madhe, e cila perfshin edhe lejen C.

Nepermjet nje komunikimi shkresor zyrtar qe shoqeria Alstezo ka pasur me organet perkatese qe leshojne keto leje mjedisit, ne daten 17.06.2016, citohet ndermjet te tjerave se: Referuar kerkeses tuaj te here ne date 12.06.2016, per sakesimin e procedures per tu pajisur me leje mjedisore per instalimin qe operon ne fushen e "Lyerja dhe lustrim i makinave, ringjyrosje e mjeteve te transportit rrugor, riparim i pajisjeve motorike dhe motocikletave dhe magazinimi i kimikateve" (..] shoqeria Alstezo shpk te aplikojte per leje mjedisore me kodin 111.1.B referuar ligjit 60/2014 date 19.06.2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar, shtojca 1 lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit kufi".

Ne ligjin 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit "te ndryshuar, jane percaktuar llojet e lejeve te mjedisit ne shtojcen 1 qe jane leje tipi A, B dhe C. Ashtu sic shihet me siper bazuar ne ligjet ne fuqi eshte e percaktuar shume dukshem se per te njejtin operator ekonomik, per te njejten vendodhje, behet vetem nje leje mjedisi pasi mund te perfshihen ne nje leje. Duke qene se aktivitetet jane te zhvilluara ne nje vend dhe nga i njejti operator ekonomik qe eshte Alstezo shpk, ky subjekt eshte i pajisur me Leje Mjedisit Tipi B duke i perfshire te gjitha lejet qe eshte e mundur te perfshihen ligjerisht dhe qe jane lejet e Tipit C qe paraqiten ne QKB me kodin III.1.A qe jane lejet me te thjesht mjedisore dhe qe inkorporohen Brenda lejes se tipit B. Per kete arsye subjekti ynë "Alstezo" sh.p.k. është pajisur me leje mjedisore të tipit B dhe ka leje mjedisore të tipit C me kodin III.1.A. pasi janë të inkorporuara në një leje, dhe smund të bëhen me disa leje pra një leje për cdo veprimtari, pasi do të nënku-ptonte shkeljen e ligjit të lejeve të mjedisit për këtë arsye është miratuar një leje që i përfshin të gjithë në një.

Veprimtarite qe disponon shoqeria jone sipas ligjit 60/2014 jane konkretisht veprimtarite qe gjenden ne lejen 111.1.B qe ka te inkorporuar te gjitha veprimtarite qe permbledhin kodet me poshte:

- ringjyrosje dhe risprucim --- qe ka kodin perkates III. I .A pasi eshte leje e tipit C
- lysterje dhe lustrim i makinave -----kodin e ka III.1.B pasi eshte leje e tipit B
- riparim i pajisjeve motorike ----- kodin e ka 111.1.A pasi eshte leje e tipit C
- larje dhe pastrim i mjeteve motorike --- kodin e ka III. I. A pasi leja eshte e tipit C

Kjo do te thote dhe verteton se shoqeria Alstezo ka nje leje III.1.B ne te cilen jane perfshire lejet e Tipit C te mesiperme qe ne QKB pasqyrohen me kodin III. I .A. Me konceptin dhe percaktirnin e lejes se Tipit B eshte percaktuar me se miri dhe cdo te thote leje e tille dhe kush perfshihet ne te. Nese shihet mire dokumenti i paraqitur nga shoqeria jone aty jane perfshire te gjitha fushat e veprimtarise dhe nukjane te ndara, pra nuk ka marre nga nje leje per cdo proces apo veprimtari qe te kete nje leje C me kodin III. I. A me vete per ringjyrosjen dhe risprucirnin, apo nje leje tjeter me vete e tipit C me kodin III. I .A per riparimin e pajisjeve motorike, e keshtu me rradhe, por shoqeria jone bazuar ne ligjet mesiper ka marre nje leje te tipit B qe ka te inkorporuar disa leje dhe kjo vertetohet shume mire po te shikohet Emertirni pershrues i veprimtarise ku jane te perfshira disa veprimtari: Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; lysterja dhe lustrimi i makinave; riparim i pajiseve motorike dhe motocikletave; larje dhe pastrim mjetesh motorike; procese apo veprimtari te ndryshme qe kane edhe lejet e mjedisit secila, por qe bazuar te ligji me siper, jane inkorporuar ne nje leje mjedisi me nje kategori mete larte se ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Ka rendesi qe nga anajone jane te perfshira ne nje leje mjedisore me kategori mete larte se C, te gjitha veprimtarite qe perkojne me objektin e prokurimit dhe qe jane kerkuar nga AK.

Bashkelidhur do te keni te gjitha dokumentat e duhura dhe te nevojshme qe vertetojne plotesimin e kriterit nga shoqeria jone.

Duke qene se shoqeria jone eshte skualifikuar pa te drejte, konstatojme se Ak nuk ka qene objektiv dhe i sakte gjate vleresimit dhe shqyrtirnit te ofertave te paraqitura, duke kualifikuar shoqeri qe nuk plotesojne kriteret per kualifikim. Konkretisht, Shoqeria jone si shoqeri qe ushtron aktivitet prej shume vitesh ne kete fushë si dhe nga verifikimet e buletineve te APP gjykon se shoqeria e kualifikuar ka mangesi ne dokumentacion.

Ne mendojme se shoqeria Kadiu nuk ploteson kriterin e percaktuar ne piken 2 te shtojces 7 te DST tek pika 2.3.3 ku kerkohet si vijim:

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka mesatarisht 10 (dhjete) punonjes, ku ne stafin e tij te jene te përfshirë të pakten: inxhinier mekanik (një) ,elektrout (nje), motorist (dy) ,pompist (nje), xhenerik (dy), bojaxhi (nje), llamarinist (nje), gomist (nje).

- *Këtë kërkesë operatori ekonomik ofertues duhet ta vërtetojë me anë të listpagesave të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, formularin përkatës, për të gjithë periudhën nentor – dhjetor 2018 si dhe janar-maj 2019.*

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu CV-të e stafit teknik të përcaktuar me lart, të nevojshëm për realizimin e kontratës, si dhe

- *Diplomën (origjinale ose kopje e noterizuar) dhe kontratën e punës konform akteve ligjore për inxhinierin mekanik. Kontrata e punës duhet të ketë afat vlefshmërie për të gjithë vitin 2019.*

- *Për personelin tjetër teknik ofertuesi duhet të paraqesë për të gjithë punonjësit kontratën e punës dhe deshmitë e kualifikimit kur kane te tilla. Afati i vlefshmërisë së kontratave duhet të jetë detyrimisht për të gjithë vitin 2019.*

Sa me siper, ne gryojme se ky operator ka mangesi ne paraqitjen e dokumentave te stafit si CV e stafit te deklaruar, mungojne listepagesat per te gjithe muajt e kerkuar ne DST, punonjesit qe jane deklaruar nukjane ne listepagesat per te gjithe periudhen dhe nukjane me kodet e duhura sipas profesioneve te deklaruarra sipas VKM 514, date 20.09.2017.

Nuk ka paraqitur kontratat e punes te vlefshme per te gjithe stafin e kerkuar dhe te deklaruar. Nuk ploteson kriterin per kontratat e ngjashme dhe ka mungese fizike ne dokumentacionin per keto kontrata te ngjashme.

Dyshojme dhe kerkojme te behet verifikim per certifikaten ISO, se kjo shoqeri nuk ploteson kriterin e percaktuar ne piken 7 te shtojces 7 te dst ku kerkohet: Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i Certifikuar sipas standarteve perkatesisht: ISO 9001 e vlefshme per aktivitetin qe ushtron lidhur me riparimin e automjeteve.

Kerkojme te verifikohet kjo certifikate, leshimi i saj nese eshte here nga nje organizem i certifikuar sipas percaktimeve ligjore ne fuqi dhe rekomandimit udhezues ne faqen e APP dhe objekti i kesaj certifikate?!

Nuk disponon mjetet e duhura dhe pajisjet si dhe ambientet e servisit pika 10 e dst sepse nuk i verteton me foto keto kritere.

Si perfundim kerkojme kualifikimin e shoqerise sone, shpalljen fitues te saj dhe skualifikimin e operatereve te kualifikuar e te renditur ne vend te pare.

Te gjitha keto kritere i sherbejne nje qellimi te vetem, qe te sigurojne autoritetin qe OE disponon kapacitetet e duhura per te kryer kete sherbim qe eshte servisi dhe mirembajtja e mjeteve. Nga ana jone eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i duhur per me teper kemi paraqitur te gjithe dokumentat e cituara me lart, qe vertetojne se ne e permbushim dhe tejkalojme kriterin e paraqitur. Pra pretendimi i AK-se lidhur me kete kriter nuk qendron

Oferta ekonomike e paragitur ne kete tender nga shogeria Alstezo sha eshte edhe oferta ekonomike me e ulet, duke i kursyer buxhetit te shtetit nie vlere te konsiderueshme.

Përfundimisht kërkohet që AK-ja të bëjë riklasifikimin e ofertave duke kualifikuar ofertën tonë ekonomike në këtë procedurë prokurimi dhe duke skualifikuar kompaninë e kualifikuar pa të drejtë në kuadër të parimeve të barazisë transparencës etj.

II.5.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit rezulton se nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda afatave ligjore të parashikuara në ligj.

II.5.3. Në datën 02.10.2019 operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, në të cilën ka parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e bërë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]Kemi marre pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar me dt.04.09.2019, nga AK - FSDKSH me objekt "mirembajtje, riparim dhe vendosje e pjeseve te kembimit per automjetet e fondit", me fondin limit: 2.708.886 (dy milion e shtateqind e tete mije e teteqind e tetedhete e gjashte) Leke pa TVSH. Jemi njohur me klasifikimin e ofertave me dt.09.09.2019, si me poshte vijon:

- | | | |
|----|----------------------------|------------------------------|
| 1. | “Poëer Industries” sh.p.k. | 2.268.000 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Sërvis Auto 2000” sh.p.k. | 2.486.990 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Alstezo” sh.p.k. | 2.691.000 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Kadiu” sh.p.k. | 2.706.800 lekë, kualifikuar |

Jemi informuar se oferta jone eshte refuzuar dhe skualifikuar nga ana e KVO-se se ketij Mungon leja mjedisore e tipit C, kodi III.1A, ne kundershtim me piken 2.3, per kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C, Kodi III.1.A. Kemi bere ankese per skualifikimin e shoqerise sone dhe ne daten 16.09.2019 kemi protokolluar ankesen prane autoritetit kontraktor ku kundershtuam skualifikimin tone site padrejte e te pabazuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si edhe kundershtuam kualifikimin e operatoreve ekonomike pjesemarres. E kundershtojme kete klasifikim, pasi eshte bere ne kundershtim me Rregullat e Prokurimit Publik, nderkohe qe ne si Operator ekonomik i plotesojme te gjitha kerkesat e vendosura nga AK ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, si dhe kemi rezervat tona per klasifikimin ne teresi te Operatoreve ne kete procedurë prokurimi. Deri më sot më datë 30.09.2019 nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga autoriteti kontraktor për ankesën e paraqitur nga ne, dmth ai nuk është përgjigjur brenda afatit ligjor të percaktuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Ankesa jone prane KPP paraqitet brenda afatit te percaktuar ne nenin 63 te ligjit per prokurimin publik.

E kundershtojme kete vendim te KVO-se per skualifikimin e ofertes tone duke i qendruar me force pretendimeve dhe kundershtimeve qe kemi ngritur prane autoritetit kontraktor, me argumentimin, konkretisht, si me poshte:

Lidhur me piken e pare te pretenduar nga AK, sqarojme: Autoriteti Kontraktor pretendon, si me poshte: Mungon Leja mjedisore e tipit C, kodi JILi.A, ne kundershtim me piken 2.3 per kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C, Kadi Ill I .A.Ne Shtojcen e DST, shtojca 7, pika 2.3. pika 6, nga ana e AK-se eshte kerkuar:

Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C, Kodi III. IA, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III. LB, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB).

Sqarojme se ne plotesim te ketij kriteri, lidhur me kryerjen e sherbimit dhe te riparimeve, ne si Operator kemi paraqitur dokumentat ne emer te Shoqerise ALSTEZO sha, sikurse jane:

Lejen e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, ku eshte percaktuar kodi 111.1.B per ndikimin ne mjedis, nenkategoria Leje e Mjedisit e tipit B, me emertim pershkrues te veprimtarise " Leje Mjedisit e tipit B per : Ringjyrosje ose sprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe motocikletave; Larje dhe pastrim mjetesh motorike"

Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar leje mjedisore e tipit C kodi III. LA per veprimtarine objekt prokurimi, dhe leje mjedisore e tipit B kodi III.Lb per repartin e bojatisjes se mjeteve. Autoriteti kontraktor nuk e ka lexuar me vemendje dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria jone, ne te kundert do te shihet se ky dokumentacion eshte ne perputhje me kriterin e kerkuar si dhe me legjislacionin ne fuqi.

Sa me siper, sqarojme KVO se legjislacioni ne fushen e mjedisit i ka te percaktuar shume qarte kategorite dhe tipet e lejeve qe leshohen ne fusha te caktuara.

Konkretisht, ne ligjin 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, ne Nenin 3, pika 13 eshte cituar :

13. "Leje mjedisit e tipit B" eshte leja e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila leshohet nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, t'eresisht ose pjeserisht, instalimit te tipit B, siaps percaktimit te ketij ligji dhe qe permban te shkuara kushtet e nevojshme per te garantuar se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime ose pjese te instalimeve ne te njejten vendndodhje dhe ge operohen nga nie i nieiti operator.

Ndersa ne nenin 20 po te ligjit 10448 date 14.07.2011 eshte percaktuar se: "E njejta leje mjedisit e tipit B mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtit operator, ne te njejten vendndodhje. Instalimet e operatoreve te ndryshem, qe ndodhen ne te njejten vendndodhje dhe instalimet e te njejtit operator, qe ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kerkojne leje te vecanta te tipave A, B apo C, sipas rastit".

Sa me siper ne nje vendndodhje mund te besh nje leje B qe ti perfshije te gjitha - pra dhe lyerjen dhe servisin per riparim te mjeteve motrrike vetem nje leje mjedisit. Kategoria zgjidhet ajo me e madhja, pra kategoria B, si kategori me e madhe, e cila perfshin edhe lejen C.

Nepermjet nje komunikimi shkresor zyrtar qe shoqeria Alstezo ka pasur me organet perkatese qe leshojne keto leje mjedisit, ne daten 17.06.2016, citohet ndermjet te tjerave se: Referuar kerkeses tuaj te here ne date 12.06.2016, per sakesimin e procedures per tu pajisur me leje mjedisore per instalimin qe operon ne fushen e "Lyerja dhe lustrim i makinave, ringjyrosje e mjeteve te transportit rrugor, riparim i pajisjeve motorike dhe motocikletave dhe magazinimi i kimikateve" (..] shoqeria Alstezo shpk te aplikojte per leje mjedisore me kodin 111.1.B referuar ligjit 60/2014 date 19.06.2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar, shtojca 1 lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit kufi".

Ne ligjin 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit "te ndryshuar, jane percaktuar llojet e lejeve te mjedisit ne shtojcen 1 qe jane leje tipi A, B dhe C. Ashtu sic shihet me siper bazuar ne ligjet ne fuqi eshte e percaktuar shume dukshem se per te njejtin operator ekonomik, per te njejten vendodhje, behet vetem nje leje mjedisi pasi mund te perfshihen ne nje leje. Duke qene se aktivitetet jane te zhvilluara ne nje vend dhe nga i njejti operator ekonomik qe eshte Alstezo shpk, ky subjekt eshte i pajisur me Leje Mjedisit Tipi B duke i perfshire te gjitha lejet qe eshte e mundur te perfshihen ligjerisht dhe qe jane lejet e Tipit C qe paraqiten ne QKB me kodin III.1.A qe jane lejet me te thjesht mjedisore dhe qe inkorporohen Brenda lejes se tipit B. Per kete arsye subjekti ynë "Alstezo" sh.p.k. është pajisur me leje mjedisore të tipit B dhe ka leje mjedisore të tipit C me kodin III.1.A. pasi janë të inkorporuara në një leje, dhe smund të bëhen me disa leje pra një leje për cdo veprimtari, pasi do të nënku-ptonte shkeljen e ligjit të lejeve të mjedisit për këtë arsye është miratuar një leje që i përfshin të gjithë në një.

Veprimtarite qe disponon shoqeria jone sipas ligjit 60/2014 jane konkretisht veprimtarite qe gjenden ne lejen 111.1.B qe ka te inkorporuar te gjitha veprimtarite qe permbledhin kodet me poshte:

- ringjyrosje dhe risprucim --- qe ka kodin perkates III. I .A pasi eshte leje e tipit C
- lysterje dhe lustrim i makinave ----kodin e ka III.1.B pasi eshte leje e tipit B
- riparim i pajisjeve motorike ----- kodin e ka 111.1.A pasi eshte leje e tipit C
- larje dhe pastrim i mjeteve motorike --- kodin e ka III. I. A pasi leja eshte e tipit C

Kjo do te thote dhe verteton se shoqeria Alstezo ka nje leje III.1.B ne te cilen jane perfshire lejet e Tipit C te mesiperme qe ne QKB pasqyrohen me kodin III. I .A. Me konceptin dhe percaktirnin e lejes se Tipit B eshte percaktuar me se miri dhe cdo te thote leje e tille dhe kush perfshihet ne te. Nese shihet mire dokumenti i paraqitur nga shoqeria jone aty jane perfshire te gjitha fushat e veprimtarise dhe nukjane te ndara, pra nuk ka marre nga nje leje per cdo proces apo veprimtari qe te kete nje leje C me kodin III. I. A me vete per ringjyrosjen dhe risprucirnin, apo nje leje tjeter me vete e tipit C me kodin III. I .A per riparimin e pajisjeve motorike, e keshtu me rradhe, por shoqeria jone bazuar ne ligjet mesiper ka marre nje leje te tipit B qe ka te inkorporuar disa leje dhe kjo vertetohet shume mire po te shikohet Emertirni pershkrues i veprimtarise ku jane te perfshira disa veprimtari: Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; lysterja dhe lustrimi i makinave; riparim i pajiseve motorike dhe motocikletave; larje dhe pastrim mjetesh motorike; procese apo veprimtari te ndryshme qe kane edhe lejet e mjedisit secila, por qe bazuar te ligji me siper, jane inkorporuar ne nje leje mjedisi me nje kategori mete larte se ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Ka rendesi qe nga anajone jane te perfshira ne nje leje mjedisore me kategori mete larte se C , te gjitha veprimtarite qe perkojne me objektin e prokurimit dhe qe jane kerkuar nga AK .

Bashkelidhur do te keni te gjitha dokumentat e duhura dhe te nevojshme qe vertetojne plotesimin e kriterit nga shoqeria jone.

Duke qene se shoqeria jone eshte skualifikuar pa te drejte, konstatojme se Ak nuk ka qene objektiv dhe i sakte gjate vleresimit dhe shqyrtirnit te ofertave te paraqitura, duke kualifikuar shoqeri qe nuk plotesojne kriteret per kualifikim. Konkretisht, Shoqeria jone si shoqeri qe ushtron aktivitet prej shume vitesh ne kete fushë si dhe nga verifikimet e buletineve te APP gjykon se shoqeria e kualifikuar ka mangesi ne dokumentacion.

Ne mendojme se shoqeria Kadiu nuk ploteson kriterin e percaktuar ne piken 2 te shtojces 7 te DST tek pika 2.3.3 ku kerkohet si vijim:

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka mesatarisht 10 (dhjete) punonjes, ku ne stafin e tij te jene te përfshirë të pakten: inxhinier mekanik (një) ,elektrout (nje), motorist (dy) ,pompist (nje), xhenerik (dy), bojaxhi (nje), llamarinist (nje), gomist (nje).

- *Këtë kërkesë operatori ekonomik ofertues duhet ta vërtetojë me anë të listpagesave të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, formularin përkatës, për të gjithë periudhën nentor – dhjetor 2018 si dhe janar-maj 2019.*

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu CV-të e stafit teknik të përcaktuar me lart, të nevojshëm për realizimin e kontratës, si dhe

- *Diplomën (origjinale ose kopje e noterizuar) dhe kontratën e punës konform akteve ligjore për inxhinierin mekanik. Kontrata e punës duhet të ketë afat vlefshmërie për të gjithë vitin 2019.*

- *Për personelin tjetër teknik ofertuesi duhet të paraqesë për të gjithë punonjësit kontratën e punës dhe deshmitë e kualifikimit kur kane te tilla. Afati i vlefshmërisë së kontratave duhet të jetë detyrimisht për të gjithë vitin 2019.*

Sa me siper, ne gjojme se ky operator ka mangesi ne paraqitjen e dokumentave te stafit si CV e stafit te deklaruar, mungojne listepagesat per te gjithe muajt e kerkuar ne DST, punonjesit qe jane deklaruar nukjane ne listepagesat per te gjithe periudhen dhe nukjane me kodet e duhura sipas profesioneve te deklaruarra sipas VKM 514, date 20.09.2017.

Nuk ka paraqitur kontratat e punes te vlefshme per te gjithe stafin e kerkuar dhe te deklaruar. Nuk ploteson kriterin per kontratat e ngjashme dhe ka mungese fizike ne dokumentacionin per keto kontrata te ngjashme.

Dyshojme dhe kerkojme te behet verifikim per certifikaten ISO, se kjo shoqeri nuk ploteson kriterin e percaktuar ne piken 7 te shtojces 7 te dst ku kerkohet: Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i Certifikuar sipas standarteve perkatesisht: ISO 9001 e vlefshme per aktivitetin qe ushtron lidhur me riparimin e automjeteve.

Kerkojme te verifikohet kjo certifikate, leshimi i saj nese eshte here nga nje organizem i certitifikuar sipas percaktimeve ligjore ne fuqi dhe rekomandimit udhezues ne faqen e APP dhe objekti i kesaj certifikate?!

Nuk disponon mjetet e duhura dhe pajisjet si dhe ambjentet e servisit pika 10 e dst sepse nuk i verteton me foto keto kritere.

Si perfundim kerkojme kualifikimin e shoqerise sone, shpalljen fitues te saj dhe skualifikimin e operatereve te kualifikuar e te renditur ne vend te pare.

Te gjitha keto kritere i sherbejne nje qellimi te vetem, qe te sigurojne autoritetin qe OE disponon kapacitetet e duhura per te kryer kete sherbim qe eshte servisi dhe mirembajtja e mjeteve. Nga ana jone eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i duhur per me teper kemi paraqitur te gjithe dokumentat e cituara me lart, qe vertetojne se ne e permbushim dhe tejkalojme kriterin e paraqitur. Pra pretendimi i AK-se lidhur me kete kriter nuk qendron

Oferta ekonomike e paragitur ne kete tender nga shogeria Alstezo sha eshte edhe oferta ekonomike me e ulet, duke i kursyer buxhetit te shtetit nie vlere te konsiderueshme.

Përfundimisht kërkohet që AK-ja të bëjë riklasifikimin e ofertave duke kualifikuar ofertën tonë ekonomike në këtë procedurë prokurimi dhe duke skualifikuar kompaninë e kualifikuar pa të drejtë në kuadër të parimeve të barazisë transparencës etj.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 5840 prot., datë 17.10.2019, protokolluar me tonën në datën 21.10.2019, me objekt *“Informacion i detajuar lidhur me zbatimin e Vendimeve 1540/1Protokolli, datë 01.10.2019 dhe nr. 1554/1prot., datë 07.10.2019 mbi procedurën e prokurimit me objekt Mirëmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.7. Në datën 03.10.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 59 prot., operatori ekonomik *“Power Industries”* sh.p.k., ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me objekt: *“Mirëmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”*, me fond limit 2.7.8.886 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“Power Industries”* sh.p.k., pas shqyrtimit të pretendimeve të tij si edhe kërkesës së paraqitur prej tij datë 07.10.2019, Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton:

III.1.1. Operatori ekonomik *“Poëer Industries”* sh.p.k., ka kërkuar të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me vlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit *“Kërkesë për Propozim”* me nr. REF-32155-07-31-2019 me objekt: *“Mirëmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”*, me fond limit 2.7.8.886 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).”

III.1.2. Duke qenë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar dhe ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative”*, i ndryshuar, KPP do t'i referohet situatave analoge me çështjet gjyqësore për të cilat parashikohen në

nenin 201 “Heqja dorë nga gjykimi dhe nga e drejta e padisë” të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit [.....]”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimit dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik sjell si rrjedhojë pushimin e procedimit administrativ.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. mbi skualifikimin e tij për shkak se Mungon leja mjedisore e tipit C, kodi III.1A, ne kundërshtim me piken 2.3, per kapacitetin teknik, pika 6, ku parashikohet Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C, Kodi III.1.A., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. III. 1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka parashikuar se: *“6.Operatori ekonomik ofertues te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit C,Kodi III.1A, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III.1.B, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB).”*

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. ka dorëzuar:

- *Leje Kodi III.1.B. e tipit “B”“Rivendosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave; Larje dhe pastrim i mjeteve motorike;“ me nr. PN-3514-08-2016*
- *Leje Kodi VII. 3.B.1 (++++) “Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me notor dhe rimorkiove. B) Riparim dhe mirëmbajtja e karrocërise të mjeteve rrugore dhe motor dhe rimorkiove. C) Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantitelektrik, të mjeteve rrugore me motordhe rimorkiove. ç) Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore ;“ me nr. LN-4699-03-2018*
- *Leje Kodi VII.3.B.1 (++++) “Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me notor dhe rimorkiove. B) Riparim dhe mirëmbajtja e karrocërise të mjeteve rrugore dhe motor dhe rimorkiove. C) Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantitelektrik, të mjeteve rrugore me motordhe rimorkiove. ç) Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove; d) Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio;“ me nr. LN-2473-12-2016*
- *Leje Kodi VII.3.B.3 (+) “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove. b) Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi“ me nr. LN-4698-03-2018*

- *Leje Kodi VII.3.B.3 (+) “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove. b) Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi“ me nr. LN-4700-03-2018*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

Në nenin 28, pika 5, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose [...]”.

Në seksionin Fusha III, “Kategoria III.1. “ Për ndikimin në mjedis” , pika 1 dhe 2 gërma “a” të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”11[11]. 2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

- a) “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A;
- b) “leje mjedisore” me kodin III.1.B;
- c) “leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C. 3. Emërtimi në pikën 2.a zëvendëson emërtime “autorizim mjedisor” dhe “pëlqim mjedisor” që përdoren para fillimit të zbatimit të këtij vendimi sipas pikës 7 më poshtë. 4. Leja e nënkategorive A, B, C, trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesë prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL, për nënkategoritë A, B, C janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, dhe aktet nën/ligjore në zbatim të tij

Në shtojcën e ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se:

Fusha III Mjedisi dhe burime mjedisore bazë

Leje

Në nenin 29 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, parashikohet se: *Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut: a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A; b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; c) kategoria e veprimtarive C, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C. Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se: Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime .*

Në nenin 4 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, I ndryshuar” i cili në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se:

Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë: a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

Ndërsa në nenin 3 pika 13 të tij parashikohet:

13. “Leje mjedisi e tipit B” është leja e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

Gjithashtu në nenin 20 pika 2 të tij konkretisht KREU III “LEJET E MJEDISIT TË TIPIT B” , “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” parashikohet: “[...]2. E njëjta leje mjedisi e tipit B mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator, në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipave A, B apo C, sipas rastit.[...]”

Në nenin 8 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. 2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e me shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A, B apo C, sipas rastit. 3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk përgatit lejen e mjedisit të tipit A, kur provon mbi baza objektive se: a) pas zotërimit të asaj lejeje, kërkuesi nuk do të jetë operator i instalimit në fjalë; b) kërkuesi nuk do të sigurojë funksionimin e instalimit, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen në lejen përkatëse të mjedisit të tipit A. Për qëllime të këtij paragrafi, merret në konsideratë edhe historia e deriatëhershme e këtij kërkuesi të lejes dhe/ose historia e deriatëhershme e instalimit.

Në Ligjin nr.60/2014 “Për një ndryshim nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar” shtojca 1 parashikohet se:

SHTOJCA 1

LEJET E MJEDISIT TË TIPAVE A, B DHE C NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES KUFÏ

SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT A parashikohet se : [...]Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

III.2.4. Operatori ekonomik pretendon se: “[...] Nepermjet nje komunikimi shkresor zyrtar qe shoqeria Alstezo ka pasur me organet perkatese qe leshojne keto leje mjedisi, ne daten 17.06.2016, citohet ndermjet te tjerave se: Referuar kerkeses tuaj te here ne date 12.06.2016, per sakesimin e procedures per tu pajisur me leje mjedisore per instalimin qe operon ne fushen e "Lyerja dhe lustrim i makinave, ringjyrosje e mjeteve te transportit rrugor, riparim i pajisjeve motorike dhe motocikletave dhe magazinimi i kimikateve" (..) shoqeria Alstezo shpk te aplikojte per leje mjedisore me kodin 111.1.B referuar ligjit 60/2014 date 19.06.2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar, shtojca 1 lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit kufi".

Ne ligjin 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit "te ndryshuar, jane percaktuar llojet e lejeve te mjedisit ne shtojcen 1 qe jane leje tipi A, B dhe C. Ashtu sic shihet me siper bazuar ne ligjet ne fuqi eshte e percaktuar shume dukshem se per te njejtin operator ekonomik, per te njejten vendodhje, behet vetem nje leje mjedisi pasi mund te perfshihen ne

nje leje. Duke qene se aktivitetet jane te zhvilluara ne nje vend dhe nga i njejti operator ekonomik qe eshte Alstezo shpk, ky subjekt eshte i pajisur me Leje Mjedisi Tipi B duke i perfshire te gjitha lejet qe eshte e mundur te perfshihen ligjerisht dhe qe jane lejet e Tipit C qe paraqiten ne QKB me kodin III.1.A qe jane lejet me te thjesht mjedisore dhe qe inkorporohen Brenda lejes se tipit B. Per kete arsye subjekti yne "Alstezo" sh.p.k. eshte pajisur me leje mjedisore te tipit B dhe ka leje mjedisore te tipit C me kodin III.1.A. pasi jane te inkorporuara ne nje leje, dhe smund te behen me disa leje pra nje leje per cdo veprimtari, pasi do te nenku-ptonte shkeljen e ligjit te lejeve te mjedisit per kete arsye eshte miratuar nje leje qe i perfshin te gjith ne nje.

Veprimtarite qe disponon shoqeria jone sipas ligjit 60/2014 jane konkretisht veprimtarite qe gjenden ne lejen III.1.B qe ka te inkorporuar te gjitha veprimtarite qe permbledhin kodet me poshte:

- ringjyrosje dhe risprucim --- qe ka kodin perkates III. I .A pasi eshte leje e tipit C
- lysterje dhe lustrim i makinave -----kodin e ka III.1.B pasi eshte leje e tipit B
- riparim i pajisjeve motorike ----- kodin e ka III.1.A pasi eshte leje e tipit C
- larje dhe pastrim i mjeteve motorike --- kodin e ka III. I. A pasi leja eshte e tipit C

Kjo do te thote dhe verteton se shoqeria Alstezo ka nje leje III.1.B ne te cilen jane perfshire lejet e Tipit C te mesiperme qe ne QKB pasqyrohen me kodin III. I .A. Me konceptin dhe percaktirnin e lejes se Tipit B eshte percaktuar me se miri dhe cdo te thote leje e tille dhe kush perfshihet ne te. Nese shihet mire dokumenti i paraqitur nga shoqeria jone aty jane perfshire te gjitha fushat e veprimtarise dhe nuk jane te ndara, pra nuk ka marre nga nje leje per cdo proces apo veprimtari qe te kete nje leje C me kodin III. I. A me vete per ringjyrosjen dhe risprucirnin, apo nje leje tjeter me vete e tipit C me kodin III. I .A per riparimin e pajisjeve motorike, e keshtu me rradhe, por shoqeria jone bazuar ne ligjet mesiper ka marre nje leje te tipit B qe ka te inkorporuar disa leje dhe kjo vertetohet shume mire po te shikohet Emertirni pershkrues i veprimtarise ku jane te perfshira disa veprimtari: Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; lysterja dhe lustrimi i makinave; riparim i pajiseve motorike dhe motocikletave; larje dhe pastrim mjetesh motorike; procese apo veprimtari te ndryshme qe kane edhe lejet e mjedisit secila, por qe bazuar te ligji me siper, jane inkorporuar ne nje leje mjedisi me nje kategori mete larte se ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Ka rendesi qe nga anajone jane te perfshira ne nje leje mjedisore me kategori mete larte se C, te gjitha veprimtarite qe perkojne me objektin e prokurimit dhe qe jane kerkuar nga AK.

Bashkelidhur do te keni te gjitha dokumentat e duhura dhe te nevojshme qe vertetojne plotesimin e kriterit nga shoqeria jone.[...]"

III.2.5. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Konstatohet se në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, si edhe nenit 46 pika 1 dhe nenit 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar në bazë të së cilës vendosen edhe kriteret e veçanta për kualifikim qëllimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor lidhet me vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë licencat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së kontratës së prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e licencës së tipit C, Kodi III.1.A, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB)”. Ligji specifik që rregullon këtë fushë është ligji nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar i cili në shtojcën e tij parashikon se: “[...]Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo[...]”. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim verifikimin dhe marrjen e një informacioni sa më të saktë në lidhje me këto licencime, iu drejtua institucionit përkatës kompetent, ku ky i fundit në lidhje me licencimet e mësipërme sqaron se: “kur një operator kryen veprimtari të ndryshme në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë, pra leja e tipit C III.1 A në këto rast është e integruar”.

Në rastin konkret referuar edhe përshkrimin të veprimtarisë së përcaktuar në lejen mjedisore të operatorit ekonomik ankimues, e cila është Kodi III.1.B., leje mjedisi e tipit B, ku specifikohet dhe janë të integruara të gjitha shërbimet si: “Rivendosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave; Larje dhe pastrim i mjeteve motorike”, referuar edhe sqarimit dhe informacionit të organit përkatës kompetent, konstatohet se operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., me dokumentacionin e paraqitur vërteton se disponon lejen e mjedisit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit, përse kohë që kjo leje mjedisi e tipit B ka të përfshirë edhe lejen mjedisore të tipit C me kodin III.1.A, duke përfshirë kështu edhe kryerjen e disa funksioneve dhe veprimtari sic është në përshkrimin e kësaj leje. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kriteret për kualifikim konform kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. mbi kualifikimin e shoqërisë “Kadiu” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a., mbi ofertën e shoqërisë “Kadiu” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pushojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me nr. REF-32155-07-31-2019 me objekt: “Mirmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit”, me fond limit 2.708.886 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së)”.
 2. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. dhe të korrigjohet shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1540 Protokolli
Datë 27.09.2019

Nr. 1554 Protokolli
Datë 02.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha